

- A mund të aplikojë një Organizatë e themeluar së fundmi?

Po, por mund të aplikojnë si Organizata rinore duke plotësuar kushtin ligjor që 70% të anëtarëve të jenë të rinj ose të jenë në partneritet me Organizata të tjera që plotësojnë kushtet ligjore për aplikim.

- A mund të dërgojë një organizatë dy projekt-propozime të ndryshme, si lead dhe si partner?

Po, një Organizatë mund të dërgojë më shumë se një aplikim, njëherë si Organizatë udhëheqëse (ose aplikues i vetëm) dhe njëher si partner në këtë Thirrje.

- Cili është dallimi midis bashkëpunëtorit dhe partnerit në një projekt-propozim?

Bashkëpunëtorë në projekt janë organizata ose institucione që shërbejnë si lehtësues për zbatimin e projektit por nuk përfshihen si grantmarrës dhe nuk përgjigjen për detyrimet e tyre.

Partnerët e OJF-së janë organizata/institucione të cilat marrin pjesë në planifikimin e zbatimit të projektit, dhe shpenzimet u nënshtrohen rregullave të njëjta si ato të bëra nga vetë organizata kandidate.

- A mund të ketë bashkëfinancim nga një donator tjetër në të njëjtin projekt-propozim të shpallur fitues në Thirrjen e AKR-së?

Po, mund të ketë bashkëfinancim nga donatorë të tjerë për të njëjtin projekt propozim.

- A mund të aplikohet me të njëjtin projekt i cili është refuzuar në thirrjen e mëparshme për shkak të mungesës së dokumentacionit?

Projektet e skualifikuara për mungesë dokumentacioni nuk i janë nënshtuar vlerësimit të cilësisë së projektit që nënkupton se ju mund të riaplikoni me të njëjtin projektpropozim nëse është në përputhje me prioritetet e Thirrjes Publike nr. 3.